



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501627/14

Tiranë ____/____/2017

Lënda: *Rekomandohet paraqitja në Ministrinë e Punëve të Brendshme të planit financiarë për varrimin e Dëshmorit të Atdheut N. K.*

Drejtuar: Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës
Z. Alfred MULLARAJ

I nderuar Z. Mullaraj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi I. K., i cili pretendon se i është drejtuar disa herë institucioneve të pushtetit vendor për të vendosur trupin e djalit N. K. në Varrezat e Dëshmorëve pranë Mauzoleumit të Durrësit, por kërkesa e tij nuk ka marrë zgjidhje. Djali i ankuesit ka humbur jetën gjatë detyrës si punonjës i policisë së shtetit dhe është shpallur Dëshmor i Atdheut me Vendimin Nr.405, datë 25.04.2011 të Komisionit Qëndror të Statusit "Dëshmor i Atdheut".

Referuar legjislationit në fuqi, varrimi i dëshmorit të atdheut në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në qarqe bëhet me vendim të Këshillit të Qarkut ose Prefektit. Këshilli i Qarkut i paraqet Ministrisë së Punëve të Brendshme planin financiarë për shpenzimet e varrimit (pika 3/a dhe 4 e VKM Nr.151, dt. 25.04.2001). Për këtë arsye Ju jemi drejtuar me shkresë për të na informuar nëse ishte marrë në shqyrtim kërkesa e shtetasit I. K. Në përgjigjen që na keni kthyer me shkresën Nr.1815/1 Prot., datë 07.10.2015, ndër të tjera, jemi vënë në dijeni se, kërkesa e shtetasit I. K. nuk ishte plotësuar pasi Këshilli i Qarkut Durrës ndodhej në procesin e konstituimit të tij dhe për rrjedhojë nuk mund të merrej vendimi për varrimin e djalit të ankuesit në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut Durrës. Në mungesë të një përgjigje nga ana Juaj, nëse kishte përfunduar procesi i konstituimit të Këshillit të Qarkut Durrës, i jemi drejtuar për informacion Kryetarit të Bashkisë Durrës, i cili sipas Ligjit "Për vetqeverisjen vendore" ka rol në këtë proces. Në përgjigjen e marrë nga Bashkia Durrës jemi sqaruar se, Këshilli i Qarkut Durrës, në mbledhjen e tij konstituuese të datës 15.10.2015, ka vendosur zgjedhjen e kryetarit. Ky vendim është gjetur i bazuar në ligj nga Prefekti i Qarkut Durrës Z. Rolant Xhelilaj.

Bashkëlidhur do gjeni fotokopje të Vendimit nr.13, datë 15.10.2015 të Këshillit të Qarkut Durrës dhe të shkresës së Prefektit të Qarkut Durrës.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Paraqitjen në Ministrinë e Punëve të Brendshme të planit financiarë për varrimin e Dëshmorit të Atdheut N. K. në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut Durrës.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI